

Diaspora e Shqipërisë në Shifra

INSTAT, 2020

Përmbajtja

HYRJE.....	3
1 METODOLOGJIA	4
1.1 Metodologjia e përlogaritjes së diasporës së re shqiptare.....	4
1.2 Kufizimet në metodologjinë e përlogaritjes së diasporës shqiptare.....	4
1.3 Rekomandime për të ardhmen	5
1.4 Përkufizime.....	6
2. VLERËSIMI I DIASPORËS SHQIPTARE	7
2.1 Vlerësimi i diasporës – metoda e tërthortë.....	8
3. SHQIPTARËT NË BOTË - STOKU I EMIGRACIONIT SHQIPTAR.....	10
3.1 Diaspora shqiptare – historik	10
3.2 Censet ndërkombëtare – shqiptarë të regjistruar	15
3.2.1 Profili i shqiptarëve në Evropë – të dhënat nga Censet.....	17
3.2.2 Karakteristikat demografike.....	18
3.2.3 Statusi në punësim.....	19
3.3 Diaspora shqiptare në SHBA	21
4. EMIGRACIONI DHE KARAKTERISTIKAT E TIJ - FLUKSET MIGRATORE.....	23
4.1 Impakti në dinamikën e popullsisë.....	24
5. ANKETA E MIGRACIONIT NË SHQIPËRI, 2019.....	26
• REFERENCA	28

HYRJE

Migrimi i shqiptarëve jashtë vendit nuk është një dukuri e re. Ai është i dokumentuar të paktën që në shekujt e pesëmbëdhjetë dhe të gjashtëmbëdhjetë, me largimin e një mase të madhe banorësh nga trevat shqiptare. Akoma vazhdon të mbetet veprues dhe të japë impaktet e tij domethënëse, si në aspektet demografike, po ashtu edhe ato sociale dhe ekonomike të vendit. Periudhat kohore të formimit të diasporës shqiptare ndryshojnë.

E ashtuquajtura "diaspora e vjetër" përbëhet nga emigrantë që kanë emigruar para vitit 1944, të cilët konsiderohen diasporë shumë e hershme, si dhe nga ata që u larguan gjatë viteve 1945-1990 dhe që përkon kryesisht me shqiptarët në ish-Jugosllavi.

Ndërsa "diaspora e re" përbëhet nga emigrantët që kanë emigruar pas viteve 1990 dhe përkon me valën e madhe të migrimit pas rënies së komunizmit.

Diaspora e vjetër ka qenë e vendosur kryesisht në SHBA dhe disa vende të Evropës Perëndimore, ndërsa diaspora e re është vendosur në Greqi, Itali, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, Zvicër, Francë etj. dhe më pak në vendet të diasporës së vjetër.

Ende nuk përlllogaritet një shifër e saktë e diasporës shqiptare për shkak të kompleksitetit që e karakterizon këtë fenomen.

Në vitin 2020, sipas vlerësimeve të tërthorta, numri i diasporës së re llogaritet të jetë rreth 1,68 milionë shtetas jashtë vendit ose rreth 37 % të shtetasve shqiptarë gjithsej.

Ky publikim kryhet nga INSTAT në kuadër të Strategjisë së Diasporës.

Qëllimi i tij është vlerësimi i numrit të diasporës shqiptare dhe profilit të saj mbi karakteristikat bazë demografike dhe sociale. Për të arritur në statistika edhe më gjithëpërfshirëse, INSTAT do të vazhdojë bashkëpunimin me institucionet partnere të vendeve pritëse të diasporës shqiptare.

1 METODOLOGJIA

1.1 Metodologjia e përlogaritjes së diasporës së re shqiptare

Duke pasur parasysh se shqiptarët vendbanues nuk regjistrohen sistematikisht kur largohen nga vendi dhe duke qenë se ka pak stimuj që ata të regjistrojnë largimin te autoritetet vendore, nuk ka matje të besueshme të numrit të individëve që janë larguar nga Shqipëria. Sidoqoftë, INSTAT përdor metoda të tërthorta për kryerjen e një vlerësimi mbi numrin e migrantëve i cili bazohet në të dhënat e dy censeve të njëpasnjëshëm, edhe pse ka vështirësi ose kufizime.

Censi i popullsisë dhe banesave në Shqipëri jep një vlerësim të stokut të migracionit brenda periudhës midis censeve, i cili zakonisht kryhet çdo 10 vjet dhe përmban vetëm një numër të vogël pyetjesh, të cilat nuk mund të numërojnë të gjitha ngjarjet e migrimit si: familje të tëra që lëvizin, migrimin sezonal/të përkohshëm dhe qarkullues.

Metoda e tërthortë që INSTAT përdori për një derivim të numrit të përgjithshëm të shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit si dhe strukturën e tyre moshore dhe gjinore, ishte krahasimi i dy popullsive, asaj të popullsisë banuese dhe regjistrimit civil.

Si bazë u mor popullsia më 1 janar 2020 e regjistrimit civil, e cila përmban të gjithë shtetasit shqiptar, pavarësisht vendbanimit të tyre (edhe ata që jetojnë jashtë vendit), sipas moshës dhe gjinisë. Kësaj popullsie ju zbrit popullsia e përlogaritur nga INSTAT (vlerësim vjetor), e cila i referohet popullsisë banuese në vend (personat që plotësojnë kushtin e vendbanuesit të zakonshëm - që jetojnë në vend për 12 muaj ose më shumë).

Në këtë mënyrë u përlogarit numri i diasporës së re shqiptare në 1 janar 2020.

1.2 Kufizimet në metodologjinë e përlogaritjes së diasporës shqiptare

Sipas metodës së tërthortë të prezantuar më sipër u mundësua një vlerësim i pjesshëm i diasporës shqiptare. Kjo metodë ka mundësuar thuajse një mbulim të plotë të diasporës së re, por nuk ka mbuluar diasporën e hershme - thënë ndryshe, paraardhësit e shqiptarëve të larguar nga Shqipëria, para viteve 1990. Kjo përlogaritje merr parasysh të gjithë shtetasit shqiptar që figurojnë të regjistruar në regjistrin civil, pavarësisht se jetojnë jashtë vendit.

Kufizimet që kjo metodë ka në përlogaritjen e diasporës shqiptare janë si në vazhdim:

- Nëpërmjet Regjistrit të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile nuk janë të përfshirë shqiptarët të cilët për arsye të fitimit të një shtetësie të një vendi tjetër kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare. Ka disa vende të cilat nuk e lejojnë dy-shtetësinë dhe për këtë arsye shtetasit shqiptarë janë të detyruar të heqin dorë nga shtetësia shqiptare, në këtë mënyrë këta individë çregjistrohen nga regjistri i shtetasve shqiptarë.
- Lindjet të cilat ndodhin jashtë vendit dhe janë të regjistruara në regjistrin e gjendjes civile janë të përfshira në përlogaritjet e kryera nga INSTAT, ndërkohë lindjet të cilat nuk regjistrohen në zyrat e gjendjes civile nuk janë pjesë e përlogaritjeve.
- Komunitetet e hershme shqiptare në botë, të cilët kanë lindur jashtë kufijve të Shqipërisë, mbajnë lidhje gjuhësore, kulturore e të traditës në vazhdimësi dhe që kanë dëshirë të ruajnë lidhjet me Shqipërinë, nuk janë pjesë e përlogaritjeve të INSTAT.

1.3 Rekomandime për të ardhmen

Vendet të cilat kanë si qëllim përfshirjen e diasporës së tyre në zhvillimin e vendit, nuk ju mjafton vetëm numri i tyre, por shumë i rëndësishëm është profili i tyre, si demografik ashtu dhe social e ekonomik.

Më specifikisht nevojitet të kenë informacion mbi përqendrimin e tyre, statusin arsimor dhe atë në punësim. Këto karakteristika do të ndihmojnë më së shumti qeverinë për të kuptuar më qartë potencialin profesional dhe ekonomik që ka diaspora.

Ndërtimi i regjistrit të emigrantëve, nismë e ndërmarrë tashmë nga Ministria e Brendshme, do të ndihmojë shumë në këtë drejtim.

Nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, do të bëhen përpjekje për mbledhjen e të dhënave cilësore, nga Përfaqësitë Diplomatike.

1.4 Përkufizime

Diaspora përfshin:

- a) komunitetet e hershme shqiptare në botë;
- b) çdo person, i cili është lindur në Shqipëri dhe jeton jashtë kufijve të saj;
- c) çdo person që gëzon origjinë shqiptare, i cili ka lindur jashtë kufijve të Shqipërisë, mban lidhje gjuhësore, kulturore e të traditës në vazhdimësi dhe që ka dëshirë të ruajë lidhjet me Shqipërinë.

Diaspora e vjetër përbëhet nga emigrantë që kanë emigruar para vitit 1944, të cilët konsiderohen diasporë shumë e hershme si dhe nga ata që u larguan gjatë viteve 1945-1990 dhe që përkon kryesisht me shqiptarët në ish-Jugosllavi.

Diaspora e re përbëhet nga emigrantët që kanë emigruar pas viteve 1990 e cila përkon me valën e madhe të migrimit pas rënies së komunizmit.

Shtetësia shqiptare është një lidhje e qëndrueshme juridike, që shprehet në të drejtat dhe detyrat e ndërsjella të personit fizik dhe të shtetit shqiptar. Shtetësia shqiptare fitohet, rifitohet, humbet apo lihet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i cili respekton normat e parimet e njohura të së drejtës ndërkombëtare në fushën e shtetësisë, të pranuar nga Republika e Shqipërisë.

Vendi i lindjes është vendi në të cilin ka ndodhur lindja e një personi.

NJEF- njësi ekonomike familjare i referohet një grupi personash të cilët banojnë sëbashku në një banesë dhe që ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët.

Emigrimi i pjesshëm është kur të paktën një anëtarë i NJEF (por jo e gjithë NJEF) ka emigruar.

Emigrimi i plotë është kur të gjithë anëtarët e NJEF kanë emigruar.

2. VLERËSIMI I DIASPORËS SHQIPTARE

Migracioni vazhdon të jetë një çështje e rëndësishme për shumë vende në botë, duke ndikuar si në vendet e origjinës, ashtu edhe në ato pritëse.

Shumë pak dihet për numrin vjetor aktual të migrantëve në të gjithë botën dhe informacioni i pakët i disponueshëm është kontradiktor.

Sot, vendet bazohen në definicionet e tyre se çfarë nënkuptohet me “migracion”. Kjo krijon paqëndrueshmëri për të dhënat ndërkombëtare dhe është sfidë për të kuptuar procesin me anë të të cilit personat lëvizin përtej kufijve.

Shpesh është theksuar se informacioni statistikor mbi migracionin është i pamjaftueshëm dhe jo i plotë sa i përket disponueshmërisë, harmonizimit të koncepteve, definicioneve dhe saktësisë. Është gjerësisht e njohur se të dhënat e migrimit nuk janë të lehta për t'u mbledhur dhe se sistemet e mbledhjes së të dhënave, si dhe përkufizimet e përdorura për të përcaktuar ngjarjet e migrimit ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme.

Një nga vështirësitë kryesore është mungesa e një definicioni standard për matjen e flukseve migratore. E nevojshme është që të dhënat të shkëmbehen midis vendeve të origjinës dhe destinacionit, si dhe të përgatiten procedura për vlerësimin e flukseve migratore të raportuara.

Në rastin shqiptar, matja e flukseve të migracionit është sfida kryesore.

Të vetmet të dhëna në dispozicion në lidhje me migrimin janë siguruar nga Censi i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri, i cili jep një vlerësim në lidhje me stokun e migracionit brenda periudhës midis censeve.

Siç dihet duke përdorur censet për matjen e migracionit ka vështirësi ose kufizime.

Censi i Popullsisë dhe Banesave kryhet çdo 10 vjet, përmban vetëm një numër të vogël pyetjesh dhe nuk mund të numërojë të gjitha ngjarjet e migrimit në familje të tëra që lëvizin, migrimin sezonal/të përkohshëm dhe qarkullues.

Megjithatë INSTAT, shpeshherë përdor metoda të tërthorta për matjen e këtij fenomeni kompleks, në mënyrë që të arrijë në një vlerësim të përafërt të numrit të përgjithshëm, stokut të migracionit. Pavarësisht se këto metoda nuk mund të na japin një pamje të plotë të profilit të shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit, të paktën na sigurojnë një paraqitje të strukturës së tyre moshore dhe gjinore.

2.1 Vlerësimi i diasporës – metoda e tërthortë

Një nga metodat e tërthorta që INSTAT përdor për një derivim të numrit të përgjithshëm të shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit si dhe strukturën e tyre moshore dhe gjinore, është krahasimi i dy popullsive asaj të popullsisë banuese dhe regjistrit civil. Si bazë u mor popullsia më 1 janar 2020 e regjistrit civil, e cila përmban të gjithë shtetasit shqiptarë, pavarësisht vendbanimit të tyre (edhe ata që jetojnë jashtë vendit), sipas moshës dhe gjinisë. Kësaj popullsie ju zbrit popullsia e përlogaritur nga INSTAT (vlerësim vjetor), e cila i referohet popullsisë banuese në vend (personat që plotësojnë kushtin e vendbanuesit të zakonshëm- që jetojnë në vend për 12 muaj ose më shumë). Në këtë mënyrë u përftua një vlerësim i shtetasve shqiptarë që nuk jetojnë në vend, në 1 janar 2020.

Diaspora e vlerësuar nga INSTAT përlogaritet 1.684.135 individë jashtë territorit të Shqipërisë, ku 884.719 individë janë meshkuj dhe 799.416 janë femra.

Gjatë vitit 2019 shohim një shtim të diasporës me rreth 2,6 %. Meshkujt në diasporë kanë patur një rritje me rreth 2,6 % kurse femrat u rritën me 2,7 %.

Tab. 1: Diaspora 1 janar 2020

Grup-mosha	Meshkuj	Femra	Gjithsej
0-4	44.800	40.019	84.819
5-9	60.366	51.387	111.753
10-14	64.382	55.002	119.384
15-19	59.689	50.083	109.772
20-24	67.194	54.763	121.957
25-29	76.080	68.332	144.412
30-34	86.217	88.497	174.714
35-39	88.703	86.680	175.383
40-44	84.799	78.971	163.770
45-49	74.845	65.170	140.015
50-54	58.579	48.733	107.312
55-59	45.266	37.828	83.094
60-64	31.953	25.457	57.410
65-69	17.533	13.975	31.508
70-74	8.054	6.480	14.534
75-79	5.700	9.862	15.562
80-84	3.471	4.539	8.010
85+	7.088	13.638	20.726
Gjithsej	884.719	799.416	1.684.135

Përlogaritjet e diasporës tregojnë se ajo përfshin një popullsi relativisht të re.

Grupmosha (0-14 vjeç) është rreth 19 %; pjesën kryesore e zë grupmosha (15-64 vjeç), me rreth 76 % dhe ajo mbi 65 vjeç, afërsisht 5 %.

Për vitin 2020 prezantohen dy piramida popullsie:

- (a) prezanton krahasimin e popullsisë banuese dhe diasporës,
- (b) prezanton strukturën gjinore dhe moshore të shtetasve shqiptar që jetojnë jashtë vendit (diasporës).

Fig. 1: Piramida e popullsisë banuese dhe popullsia e shtetasve shqiptar





Fig. 2: Piramida e diasporës



3. SHQIPTARËT NË BOTË - STOKU I EMIGRACIONIT SHQIPTAR

3.1 Diaspora shqiptare – historik¹

Historiku i Diasporës shqiptare është i hershëm. Vetë pozita e vendit ku jetojnë shqiptarët është e tillë që i bën ata të lëvizin në drejtime të ndryshme. Diaspora shqiptare është heterogjene në dy pikëpamje: të kohës së mërgimit, si dhe në pikëpamje të regjionit prej nga kanë ardhur. Duke analizuar aspektin kohor, bashkësitë më të vjetra shqiptare përbëhen nga arbëreshët në Itali dhe arvanitasit në Greqi. Të parët kanë arritur që për shekuj të ruajnë identitetin e tyre, kurse të dytët, janë në fazën përfundimtare të asimilimit të plotë, edhe pse mbase ka shpresë që kjo bashkësi të njohë një ringjallje sado të vogël.

Në radhën e këtyre bashkësive të vjetra mund të hyjë pa mëdyshje edhe bashkësia shqiptare e Egjiptit. Pas këtyre vijnë bashkësitë shqiptare në Turqi, SHBA, Belgjikë, Australi e në ndonjë vend tjetër. Të fundit vijnë mërgimtarët e katër dekadave të gjysmës së dytë të shek. XX.

Shumica e tyre janë vendosur apo bëjnë përpjekje të vendosen në shtetet e ndryshme të Evropës Perëndimore, në SHBA dhe Kanada. Këtu vlen të përmendim edhe 500 mijë qytetarë të Shqipërisë, të cilët në fillim të viteve nëntëdhjetë, pas hapjes së Shqipërisë ndaj botës, u shpërngulën në Greqi, Itali si dhe në vende të tjera evropiane.

Diaspora në Itali

Arbëreshët u vendosën në Itali në shekujt XIV-XV dhe emigruan kryesisht për shkak të zhvillimeve politike e luftarake në Shqipëri. Komuniteti arbëresh ka ruajtur origjinën, gjuhën, kulturën e traditat shqiptare. Arbëreshët kanë dhënë e po japin një kontribut të shquar në historinë, kulturën dhe jetën shoqërore të Italisë. Nga arbëreshët kanë dalë mjaft personalitete të shoqërisë e kulturës italiane dhe shqiptare. Arbëreshët përbëjnë një nga pakicat etno-gjuhësore më të mëdha në Itali. Prej vitit 1999, gjuha “arbreshe” njihet nga qeveria italiane si gjuha e “pakicës etnike dhe gjuhësore.”

Në fillim të viteve 1990 shqiptarët emigruan masivisht drejt Italisë, duke formuar për nga numri komunitetin e dytë më të madh të emigrantëve në këtë vend.

Diaspora në Greqi

Migrimi i arbëreshëve në Greqi filloi në fund të shekullit të 13-të dhe mbaroi rreth vitit 1600 nga një rajon e quajtur Arbëria, e cila ishte pjesë e Despotetit të Epirit dhe i cili sot është

¹ Ministri i Shtetit për Diasporën <http://online.fliphtml5.com/dmiin/kgyt/#p=1>

rajoni qendror i Shqipërisë moderne. Arbëreshët së pari migruan në Thesali rreth vitit 1325 përmes rrugëve të udhëtimit që kishin shkuar në jug-lindje duke kaluar pellgun e sipërme të lumit Bistricë dhe me anë të Korçës, Kosturit dhe Grebenesë mbërritën në fushë të Thesalisë. Një tjetër pikëpamje mban se kjo migrimi ka ndodhur nga zbritëse jug-perëndim përmes rajonit të Janinës dhe Atolo-Akarnania dhe shkuan prej andej në Thesali.

Gjithashtu në Greqi ndodhet komuniteti më i madh i emigrantëve shqiptarë, të cilët u vendosën në këtë vend pas vitit 1990. Emigrantët shqiptarë janë një vlerë e shtuar për ekonominë dhe shoqërinë në Greqi. Ata janë integruar me sukses në tregun e punës dhe në shoqërinë vendase.

Diaspora në Bullgari

Diaspora në Bullgari nisi të formohej prej shekullit XV, nga migrimi i popullatës kryesisht nga Korça, Elbasani, Çermenika, Golloborda, Dibra etj. Këto flukse ndodhën për shkak të përpjekjeve prej Perandorisë Osmane, por edhe duke migruar si punonjës stinorë, zejtarë, tregëtarë etj. Më vonë një pjesë e tyre u vendosën në Ukrainë, ndërsa një grup tjetër në Trakinë jugore. Një valë tjetër migrimi ndodhi gjatë shekujve XIX-XX, të cilët u vendosën në Sofie me marrëveshjen dypalëshe për mbrojtjen e pakicave.

Diaspora në Turqi

Në turqi ndodhet diaspora më e madhe shqiptare. Shqiptarët në Turqi kanë emigruar në të gjitha kohrat, duke filluar prej shekullit XVI, kur viset shqiptare ishin pjesë e Perandorisë Osmane. Shumica e tyre u shpërngulën në periudhën e Rilindjes dhe u vendosën në Stamboll dhe në disa qytete të Turqisë Aziatike, si Izmir, Bursë dhe Ankara. Migrimi masiv nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare drejt Turqisë ndodhi në katër periudha. Vala e parë ndodhi pas Traktatit të Lozanës në vitin 1923, vala e dytë pas marrëveshjes Ataturk-Stojadinovic në vitin 1938, ndërsa vala e tretë pas marrëveshjes së fshehtë Tito-Kyprili të vitit 1953. Një valë e katërt ndodhi në fillim të viteve 1970.

Diaspora në Rumani

Diaspora në Rumani është ndër më të shquarat për nga kontributi për pavarsinë e Shqipërisë. Ajo ishte një ndër vatrat më të fuqishme të Rilindjes Kombëtare. Migrimi ndodhi përgjatë shekujve XVII-XX.

Diaspora në Kroaci

Diaspora në Kroaci është diaspora e fundit që ruajti emërtimin arbënesh ose arbanë. Diasporat pas vitit 1731 u quajtën diaspora shoqiptare. Shqiptarët që migruan në fillim të viteve 1750 u vendosën në Hrtkovc dhe Nikinc.

Diaspora në Egjipt

Në Egjipt që nga fillimi i shekullit XVIII, me vendosjen e Mehmet Ali pashës si vali i Egjiptit, numri i shqiptarëve atje ishte rritur vazhdimisht. Dinastia shqiptare e Mehmet Ali pashës kishte sunduar vendin e faraonëve për 150 vjet, nga viti 1805 deri më 1952. Meqenëse shumica e tyre ishin ushtarë, ata ishin shpërndarë edhe nëpër vise të tjera, si në Palestinë, Siri, Liban, Libi, Hixhaz, Jemen e Sudan. Këtë më së miri e vërtetojnë pasardhësit e shumë familjeve me origjinë shqiptare që jetojnë sot atje me mbiemrin Arnauti ose El-Albani.

Diaspora në Ukrainë

Shqiptarët filluan të emigrojnë drejt Ukrainës në fillim të shekullit XVIII, por valët më të mëdha migruese ndodhën në fillim të shekullit XIX, për tu shpëtuar trazirave e rreziqeve të luftërave ruso-turke.

Diaspora në Liban

Familjet e para prej viseve shqiptare mbërritën në Liban në shekullin e XVIII, në kohën e Mehmet Ali Pashës, valiut shqiptar të Egjiptit. Rrënjët e Diasporës shqiptare të Libanit janë edhe familjet e emigraura në kohën e Vaso Pashës, Guvernatorit shqiptar të Libanit

Diaspora në Slloveni dhe Bosnje-Hercegovinë

Valët migratore të shqiptarëve drejt Sllovenisë dhe Bosnje-Hercegovinës kanë ndodhur kryesisht prej viseve të Shqipërisë Veriore, Kosovës, shqiptarëve të Maqedonisë dhe Malit të Zi. Numri i shqiptarëve u shtua gjatë dekadave të para të shekullit XX. Pas luftës së Dytë Botërore shqiptarët e Kosovës u vendosën në Slloveni dhe Bosnje-Hercegovinë në kontekstin e lëvizjes Brenda ish Jugosllavisë, kryesisht për punë, studime ose arsye politike.

Diaspora në Argjentinë

Diaspora shqiptare në Argjentinë është formuar prej diasporës arbëreshe. Fluksi më i madh drejt Argjentinës ndodhi në fillim të shekullit XX dhe shumica e tyre u vendosën në kryeqytetin Buenos Aires.

Diaspora në Siri

Shqiptarët migruan në Siri në dekadat e fundit të Perandorisë Osmane, gjatë fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, në kohën kur po rriteshin përpjekjet për pavarësinë e Shqipërisë. Një valë tjetër ndodhi gjatë viteve 1912-1913, kur shqiptarët migruan në këtë vend për t'i shpëtuar represionit serb. Shqiptarët e Sirisë janë vendosur kryesisht në Damask dhe në disa qytete të tjera të mëdha të këtij vendi.

Diaspora në Rusi

Shqiptarët filluan të migrojnë në Rusi rreth fundit të shekullit XIX, në mënyrë të tërthortë, nëpërmjet viseve të tjera të ish Perandorisë Osmane. Këto valë migrimesh ndodhën për shkak të nevojave të mëdha për fuqi punëtore në sektorët e industrisë, hekurudhave etj. Gjatë viteve 1920-1930 në ish Bashkimin Sovjetik u vendosën mjaft emigrant politikë shqiptarë.

Diaspora në Australi

Valët e para migratore të shqiptarëve drejt Australisë filluan në fund të shekullit XIX dhe u zgjeruan në dekadat e para të shekullit XX, pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë.

Diaspora në Zvicër

Diaspora shqiptare në Zvicër përbëhet nga dy grupime: shqiptarët nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare të ish Jugosllavisë, që emigruan në Gjermani, pas vitit 1971, me heqjen e vizave dalëse nga ky vend, dhe shqiptarët nga Shqipëria që migruan pas vitit 1990. Grupi I parë i diasporës shqiptare u shndërruan gradualisht nga emigrant ekonomikë në një komunitet emigrantësh politikë dhe mbështetën fuqishëm luftën për pavarësinë e Kosovës. Shqiptarët përbëjnë aktualisht popullatën e katërt më të madhe në Zvicër.

Diaspora në Gjermani

Shqiptarët nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare emigruan në Gjermani pas vitit 1971, me heqjen e vizave dalëse nga ish Jugosllavia. Pas vitit 1990 drejt Gjermanisë migruan dhjetra mijra shqiptarë nga Shqipëria.

Diaspora në Mbretërinë e Bashkuar

Prej fillimit të shekullit XX në Mbretërinë e Bashkuar kishin migruar disa intelektualë shqiptarë. Pas vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri, në Londër ishin vendosur një grup i vogël ish krerësh të organizatave antikomuniste, por pa ndikim në jetën e vendit pritës dhe

të Shqipërisë. Diaspora shqiptare në Mbretërinë e Bashkuar filloi të formohet pas vitit 1990, prej shqiptarëve emigrant ekonomikë nga Shqipëria si edhe prej disa grupimeve azil-kërkuesish nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare në rajon. Prezenca e shqiptarëve u rrit pas krizës së Kosovës në vitin 1999, ku dhjetra mijra shqiptarë, kryesisht nga Kosova dhe Shqipëria, u vendosën në këtë vend.

Diaspora në Kanada

Shqiptarët filluan të migrojnë në Kanada pas vitit 1990, duke përfituar kryesisht nga mundësitë që ofron programi I migrimit në këtë vend të specialistëve të kualifikuar.

Diaspora në Belgjikë

Diaspora shqiptare në Belgjikë u formua kryesisht pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore dhe vendosjes në Shqipëri të regjimit komunist. një pjesë e përfaqësuesve të organizatave antikomuniste, shumica me prirje monarkiste, u vendosën në këtë vend për tu organizuar e siguruar mbështetje për përmbysjen e regjimit komunist. pas vitit 1971, me heqjen e vizave dalëse nga ish Jugosllavia, shqiptarët nga Kosova dhe republikat e tjera t'ëish Jugosllavisë, u vendosën në këtë vend si emigrant ekonomikë. Pas vitit 1990 në Belgjikë emigruan edhe mjaft shqiptarë nga Shqipëria.

Diaspora në Vendet Skandinave

Diaspora shqiptare në vendet skandinave përbëhet nga tre grupime kryesore: shqiptarët e Kosovës, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut, të cilët migruan në këto vende gjatë viteve 1971-1990 si emigrant ekonomikë.

Diaspora në Austri

Austria ka qenë një destinacion i preferuar i shqiptarëve në të gjitha kohrat. Megjithatë, komuniteti më i madh i emigrantëve ekonomikë shqiptarë u vendos në këtë vend pas vitit 1990.

Diaspora në Francë

Shqiptarët filluan të migrojnë në Francë pas vitit 1990. Ndërkohë, pas vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri, kishin migruar në Francë një grup i vogël ish krerësh të organizatave antikomuniste.

3.2 Censet ndërkombëtare – shqiptarë të regjistruar

Të dhënat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe Instituteve të Statistikave të vendeve të tjera ndihmojnë për ilustrim në lidhje me destinacionet më të rëndësishme për emigrantët shqiptarë.

Sipas të dhënave të Kombeve të Bashkuara për vitin 2019, numri i emigrantëve shqiptarë në botë është rreth 1,2 milionë.

Italia dhe Greqia kanë përqindjen më të madhe të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit (rreth 75 përqind).

Duhet të theksohet se shtetësia është një karakteristikë e ndryshueshme - njerëzit mund të fitojnë shtetësinë e vendit të huaj të qëndrimit të tyre.

Gjatë vitit 2018, 24.2 mijë shqiptarë kanë fituar shtetësinë greke; në Itali 21.8 mijë shqiptarë kanë fituar shtetësinë italiane.

Së bashku me një numër të panjohur të shqiptarëve të paregjistruar, popullsia e shqiptarëve jashtë vendit do të ishte më e madhe.

Nga ana tjetër, popullsia me shtetësi shqiptare jashtë vendit përfshin një brez të dytë të fëmijëve të lindur jashtë Shqipërisë, të cilët nuk duhet të konsiderohen emigrantë.

Ato ndiqen nga SHBA, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Kanadaja, Belgjika, etj.

Në tabelën e mëposhtme tregohet shpërndarja në përqindje e emigrantëve shqiptarë sipas destinacioneve kryesore për periudhën 1995 - 2019.


Tab. 2: Shpërndarja e emigrantëve shqiptarë sipas destinacioneve kryesore, 1995 – 2019

Viti	1995	2000	2005	2010	2015	2019
Itali	31,9%	33,3%	37,4%	39,3%	39,6%	39,4%
Greqi	45,9%	48,6%	43,8%	41,5%	38,7%	35,3%
ShBA	4,5%	4,8%	5,7%	6,4%	8,1%	8,2%
Gjermani	1,7%	1,4%	1,4%	1,3%	1,3%	4,2%
Kanada	0,7%	0,8%	1,0%	1,2%	1,4%	1,4%
Mbretëria e Bashkuar	0,2%	0,3%	0,8%	0,7%	0,9%	0,9%
Belgjikë	0,4%	0,3%	0,3%	0,5%	0,8%	0,9%
Vendet e tjera	14,8%	10,7%	9,7%	9,0%	9,2%	9,7%

Burimi: [Organizata e Kombeve te Bashkuara](#)

Në grafikun në vijim paraqitet norma e rritjes vjetore të numrit gjithsej të emigrantëve shqiptarë në katër vendet kryesore destinacion.

Fig. 3: Norma e rritjes vjetore e emigrantëve shqiptarë sipas destinacioneve kryesore, 1990 – 2019



Burimi: [Organizata e Kombeve te Bashkuara](#)

Vihet re që numri i emigrantëve në Itali, Greqi dhe ShBA është rritur në mënyrë intensive gjatë pesëvjeçarëve 1990 – 1994 dhe 1995 – 1999, të cilat përbëjnë periudhën e emigracionit masiv të shqiptarëve.

Gjatë viteve 1990 – 1994, numri i emigrantëve shqiptar në Greqi, Itali dhe ShBA rritej çdo vit me rreth 30 % të numrit të vitit paraardhës. Këto norma bien në rreth 11 % gjatë periudhës 1995 – 1999.

Pas vitit 2000, norma e rritjes së numrit të emigrantëve shqiptarë në Greqi bie me shpejtësi dhe arrin në nivele negative gjatë periudhës 2010 – 2019.

Kjo do të thotë se, sipas të dhënave të Kombeve të Bashkuara, numri gjithsej i emigrantëve shqiptarë në Greqi po zvogëlohet.

Edhe në rastin e Italisë dhe ShBA, norma vjetore e rritjes së numrit të emigrantëve është zvogëluar në mënyrë konstante duke arritur në rreth 3 % përgjatë periudhës 2015 – 2019.

Nga ana tjetër numri i emigrantëve shqiptarë në Gjermani ka ndryshuar me ritme të tjera nga ato të Italisë, Greqisë dhe ShBA-ve. Gjatë viteve 1990 – 1994 ky numër rritej me rreth 10 % në vit. Më pas norma vjetore e rritjes u zvogëlua në mënyrë konstante duke arritur në rreth 1 % përgjatë periudhës 2010 – 2014. Vetëm pas vitit 2015, numri i emigrantëve shqiptarë në Gjermani filloi të rritej me një normë vjetore prej rreth 35 %, duke e kthyer këtë vend si destinacionin kryesor të tyre. Kjo ka bërë që pesha që zënë emigrantët shqiptarë në Gjermani në numrin gjithsej të emigrantëve të katërfishohet nga 1,3 % në 4,2 %.

3.2.1 Profili i shqiptarëve në Evropë - të dhënat nga Censet

Të dhënat e censeve të fundit të popullsisë dhe banesave, raundi 2010 tregojnë se 905 mijë individë të lindur në Shqipëri kanë qenë rezidentë të zakonshëm në 28 vende të Evropës; nga ana tjetër, statistikat që lidhen me shtetësinë tregojnë se 962 mijë shtetas shqiptarë jetojnë në 15 vende të Evropës.

Vendet që numërojnë një numër të lartë shtetasish shqiptar, si dhe rezidentë të lindur në Shqipëri janë: Greqi, Itali, Gjermani dhe Britani e Madhe.

Tab. 3: Shqiptarët në Europë

EVROPË	Census Hub 2011		Eurostat vlerësime 2019	
	Lindur në Shqipëri	Shtetas shqiptar	Lindur në Shqipëri	Shtetas shqiptar
Belgjikë	7.574	5.251	11.722	6.466
Bullgari	1.134	269	1.281	494
Çeki	374	-	458	443
Danimarkë	264	230	561	346
Gjermani	14.490	8.400	-	56.715
Estoni	6	-	42	36
Irlandë	823	768	-	834
Greqi	452.553	480.851	-	-
Spanjë	2.195	-	-	-
Francë	6.905	5.231	22.100*	-
Kroaci	175	237	-	-
Itali	396.540	451.437	480.521	441.027
Qipro	275	-	-	-
Letoni	9	-	13	7
Lituani	-	-	28	29
Luksemburg	480	367	1.033	626
Hungari	184	-	487	396
Maltë	75	-	-	-
Holandë	-	-	2.342	1.247

Austri	2.732	1.581	4.390	2.752
Poloni	172	215	-	-
Portugali	57	-	-	85
Rumani	430	-	715	910
Sloveni	144	-	140	109
Slovaki	55	-	132	118
Finlandë	-	-	691	568
Suedi	1.378	671	5.583	4.115
Mbretëria e Bashkuar	13.665	5.785	-	-
Islandë	32	-	203	125
Lihtenshtein	-	-	3	2
Norvegji	496	311	2.147	873
Zvicër	1.381	-	4.304	2.113

*Franca 2017²

Burimi: Eurostat³, [Census Hub](#)

3.2.2 Karakteristikat demografike

Emigrimi në dekadën e fundit shënonte: 56 % meshkuj në Gjermani dhe Greqi, dhe 51 % meshkuj në Itali. Emigrimi në Gjermani akoma ka të ngjarë të jetë i lidhur ngushtë me punësimin (dhe studimin) e cila tregohet nga raporti i ulët e fëmijëve. Në krahasim me të, Italia dhe veçanërisht

Greqia kanë një shpërndarje moshore më të gjerë, treguese e migrimit familjar.

Këto shpërndarje moshore të emigrimit reflektohen tek të dhënat në strukturën e popullsisë së Shqipërisë që aktualisht jeton jashtë vendit siç raportohet në Censin 2011.

Struktura moshore e shtetasve Shqiptarë të regjistruar në Censin Italian 2011 gjithashtu tregon qartë efektet e bashkimit familjar si dhe prezencën e një brezi të dytë: fëmijët e emigrantëve shqiptarë të lindur në Itali.


Sipas të dhënave të raundit të censeve 2010, shtetas shqiptarë që jetojnë në Evropë figurojnë të jenë të një moshe të re. Rreth 36 % e tyre i përkasin grupmoshës 30-49 vjeç.

Shifrat tregojnë se janë femrat ato që dominojnë për grup moshat nën 15 vjeç dhe 15-29 vjeç, ndërsa meshkujt janë më të shumtë në numër në grup moshën 30-49 vjeç (38,6%).

² <https://www.insee.fr/fr/statistiques/4510549?sommaire=4510556#consulter-sommaire>

³ https://appso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr_imm3ctb&lang=en

Fig. 4: Struktura moshore e shtetasve shqiptarë




Burimi: [Census Hub](#)

3.2.3 Statusi në punësim

Referuar të dhënave të censeve të vendeve evropiane destinacion të emigrantëve shqiptar, tregojnë se rreth 39,0% e shtetasve shqiptar janë të punësuar, 10,1% të papunë dhe pjesa tjetër inaktivë.

Fig. 5: Statusi në punësim




Burimi: [Census Hub](#)

Situata ndryshon, nëse gjykojnë sipas gjinisë, janë meshkuj ata që karakterizohen me një normë më të lartë punësimi sesa femrat. Sipas fotografisë së Censit 2011, në vendet evropiane destinacion të shqiptarëve, 51,6 % e shtetasve shqiptar meshkuj figurojnë të punësuar, kundrejt 24,9% të femrave shqiptare.

Pra, vihet re një hendek gjinor relativisht i konsiderueshëm në shkallën e punësimit, me shkallë më të lartë punësimi për meshkujt se sa për femra. Nëse do të analizonim shpërndarjen e statusit të punësimit sipas shteteve, do të vinim re se një përqindje e lartë e shqiptarëve meshkuj me një status në punësim “i punësuar” vihet re në Mbretërinë e Bashkuar, ndjekur nga Norvegjia dhe Danimarka. Përsa i përket shtetasve të punësuar femra ato shënojnë përqindjen më të lartë në Poloni.

Fig. 6: Shtetasit shqiptar të punësuar



Burimi: [Census Hub](#)

3.3 Diaspora shqiptare në SHBA

Shqiptarët e parë që emigruan në SH.B.A ishin arbëreshët dhe pas tyre emigrantët ekonomikë që migruan në periudhën midis Luftës së Parë dhe Luftës së Dytë Botërore. Duke vazhduar më vonë me emigrantët politikë që emigruan pas luftës së Dytë Botërore dhe vendosjes në Shqipëri të regjimit komunist.

Komunitetet shqiptare janë të konsiderueshëm edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ato mund t'i ndajmë në dy grupe të mëdha në gjeneratën e parë janë të gjithë emigrantët shqiptarë vendi i lindjes së të cilëve është Shqipëria.

Në këtë grup nuk bëjnë pjesë Shqiptarët e lindur në Kosovë, Maqedoninë e Veriut apo në vende të tjera. Gjenerata e dytë janë banorë të SH.B.A-së të cilët nuk kanë lindur në Shqipëri, por kanë prejardhje shqiptare.

Në këtë grup mund të përfshihen dhe shqiptarë nga vendet e tjera në Ballkan apo në botë për sa kohë janë vetë deklaruar në Anketën e Komunitetit Amerikan (ACS) 2019.

Tab. 4: Shqiptarë në SHBA sipas gjinisë, 2019

	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Gjenerata e parë	47.556	51.814	99.370
Gjenerata e dytë	57.885	57.702	115.587
Gjithsej	104.264	110.693	214.957

Burimi: [Anketa e Komunitetit Amerikan, 2019⁴](#)

Të dhënat e Anketës së Komunitetit Amerikan për vitin 2019 tregojnë që shqiptarë të gjeneratës së parë në vitin 2019 janë 99.370 ndërsa gjenerata e dytë është 115.587 pra një total prej 214.957 shqiptarë që jetojnë në SHBA.

Gjenerata e parë nëse e shohim sipas vitit që kanë emigruar në SHBA vëmë re që rreth 93 % kanë emigruar pas viteve 1990.

Sipas gjinisë vëmë re që femrat janë më shumë në gjeneratën e parë zënë 52,1 % të totalit ndërsa e kundërta ndodh në të dytën që zënë 49.9 %.

Gjenerata e dytë ka një moshë relativisht më të re 29,3 vjeç krahasuar me gjeneratën e parë që e ka 43,5 vjeç moshën mesatare; kjo vjen dhe për arsye se në gjeneratën e dytë pjesë të rëndësishme e zënë fëmijët e gjeneratës së parë.

⁴ ACS 2019 : <https://data.census.gov/mdat/#/search?ds=ACSPUMS1Y2019>

Shqiptarët në SHBA, janë të përqendruar në pak vende: më saktësisht 50.303 shqiptarë janë të përqendruar në New-York, duke përbërë në këtë mënyrë komunitetin më të madh, 31.954 jetojnë në Michigan, 19.645 në Florida, 18.671 në Massachusetts, 13.925 në Connecticut.

Nëse do të analizojmë karakteristikat arsimore 21.1% e shqiptatrëve kanë diplomë gjimnazi, 19 % kanë një diplomë Bachelor, ndërsa vetëm 8,4 % e shqiptarëve kanë një diplomë master ose diplomë tjetër profesionale përtej diplomës Bachelor dhe 1,2 % kanë Doktoraturë.

Tab. 5. Shqiptarë në SHBA sipas nivelit arsimor

	Gjenerata e parë	Gjenerata e dytë	Gjithsej
Nuk ka përfunduar asnjë nivel	3,2%	5,9%	4,6%
Gjimnaz	28,1%	15,0%	21,1%
Kolegj	0,1%	0,1%	0,1%
Bachelor	25,9%	13,0%	19,0%
Master	8,7%	5,3%	6,8%
Diplomë tjetër profesionale përtej diplomës Bachelor	2,3%	1,0%	1,6%
Doktoraturë	1,6%	0,9%	1,2%

Burimi: [Anketa e Komunitetit Amerikan, 2019](#)

Përsa i përket karakteristikave të tyre ekonomike, dhe specifikisht statusit në punësim të dy gjeneratat kanë norma shumë të larta të punësimit.

Shqiptarët e papunë në SHBA në 2019 zënë vetëm 2,1% kurse 22,4% nuk bëjnë pjesë në forcën e punës dhe 21,5% janë më pak se 16 vjeç.

Tab. 6: Shqiptarë në USA sipas statusit në punësim

	Gjenerata e parë	Gjenerata e dytë	Gjithsej
N/A (më pak se 16 vjeç)	5,1%	35,6%	21,5%
Të punësuar	68,3%	41,6%	53,9%
Të papunë	2,3%	1,9%	2,1%
Forcat e Armatosura	0,1%	0,1%	0,1%
Nuk janë në Forcën e Punës	24,1%	20,8%	22,4%

Burimi: [Anketa e Komunitetit Amerikan, 2019](#)

4. EMIGRACIONI DHE KARAKTERISTIKAT E TIJ - FLUKSET MIGRATORE


Migrimi ndërkombëtar ka qenë një forcë e madhe në ndryshimin e popullsisë në dy dekadat e fundit. Arsyeja kryesore për rënien e popullsisë në dy Censet e fundit ishte emigrimi në shkallë të gjerë i qytetarëve shqiptarë.

Në Shqipëri, ashtu si edhe në vende të tjera, migrimi përfshin veçanërisht të rinjtë, të cilët migrojnë për arsye punësimi, mundësi arsimimi dhe për arsye familjare.

Emigrimi ishte arsyeja kryesore për rënien e popullsisë në Shqipëri para vitit 2001 dhe në periudhën 2001-2011. Zhdukja e barrierave ndaj emigracionit dhe trazirave sociale në vitet 1990 krijoi valë të njëpasnjëshme të emigracionit në këto vite.


Disa qindra mijëra shqiptarë u larguan nga vendi (Carletto et al. 2006), një humbje që nuk u kompensua nga imigracioni dhe rritja natyrore.

Fig. 7: Numri i Imigrantëve, Emigrantëve dhe Migracioni Neto



Ky emigrim masiv ishte shkaku kryesor i ndryshimit të popullsisë nga një rritje e lartë vjetore e popullsisë në periudhën e censeve 1979-1989 prej 2,0 përqind, me një rritje negative (-0,3 për qind në vit) në periudhën pasuese të censeve 1989-2001.

Fig. 8: Numri i emigrantëve, dhe emigrantë për 1.000 banorë



Në terma absolutë, rritja e popullsisë prej pothuajse 600 mijë personave që u vëzhgua në periudhën midis censeve para vitit 1989 u shndërrua në një rënie prej më shumë se 100 mijë në atë pas vitit 1989.


Censi i vitit 2011 përfundimisht tregoi se emigrimi ishte faktori më i rëndësishëm në humbjen neto të popullsisë prej 269 mijë personave në periudhën 2001-2011, duke përbërë 8,8 % të popullsisë së vitit 2001. Sipas vlerësimeve indirekte të INSTAT-it, gjatë kësaj periudhe rreth 482 mijë shqiptarë u larguan nga vendi, një numër që u kompensua pjesërisht nga imigracioni dhe rritja natyrore.

Vazhdimi i ritmeve të larta të emigracionit lidhet edhe me ndryshimin e karakteristikave të emigracionit shqiptar. Gjatë viteve 1990 migrimi u dominua nga burrat e rinj të cilët kërkonin punë jashtë vendit në një kohë kur Shqipëria ishte në trazirë. Në dekadën e parë të këtij mijëvjeçari, migrimi duket të jetë i larmishëm:

4.1 Impakti në dinamikën e popullsisë

Pas Censit të vitit 2011, migracioni vazhdon të luajë një rol shumë të rëndësishëm në dinamikën e popullsisë. Shqipëria vazhdon dhe do të vazhdojë të përjetojë flukse dalëse të popullsisë, ashtu sikurse projeksionet e popullsisë sugjerojnë.

Fig. 9: Piramida e Popullsisë 2011- 2019



Në këtë mënyrë popullsia e Shqipërisë po shkon drejt procesit të plakjes si pasojë e uljes së lindshmërisë dhe rritjes së jetëgjatësisë dhe për më tepër emigracionit i cili vazhdon të mbetet veprues dhe që përfshin një popullsi relativisht të re.

Në vitin 2019, në popullsinë mesatare gjithsej të Shqipërisë, të rinjtë 0-14 vjeç zënë 17,0 %, popullsia në moshë pune 15-64 vjeç zë 68,5 % dhe popullsia mbi 65 vjeç përbën 14,4 % të popullsisë gjithsej. Piramida e popullsisë, e cila jep një paraqitje të strukturës moshore dhe gjinore të popullsisë, pasqyron trendin e zhvillimeve që kanë ndodhur për grup moshat në fjalë.

Tendenca drejt procesit të plakjes së popullsisë në të ardhmen vihet re nga rritja e lehtë e përpjesës që zë popullsia 65 vjeç e lart, shoqëruar kjo me uljen e numrit të popullsisë në moshë të re (0-14 vjeç).


Siç shihet qartë emigracioni përfshin një popullsi relativisht të re dhe në moshë pune dhe kjo vihet re për të dy gjinitë. Ndryshe nga vite më parë ku emigracioni dominohej nga meshkuj të rinj të cilët emigronin së shumti për arsye punësimi, dekadën e fundit emigracioni shqiptar ka marrë një tjetër trajtë – vihet re tendenca e emigracionit familjar – bashkimet familjare. Janë edhe gratë ato që tashmë së bashku me fëmijët ndjekin bashkëshortin në vendin e destinacionit.

Fig. 10: Arsyet e largimit nga Shqipëria, 2019

Emigracioni shqiptar ka qenë emigracion i dominuar nga faktorë shtytës ekonomik.

Kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë arsye ekonomike ato që shtyjnë pjesën më të madhe të shqiptarëve të largohen nga vendi.

Sipas anketës së Forcës së Punës, 2019, arsyeja kryesore e largimit nga Shqipëria është “Mundësi punësimi” me 83,7 %.



Burimi: Anketa e Forcës së Punës, 2019

5. ANKETA E MIGRACIONIT NË SHQIPËRI, 2019


Anketa e Migracionit në Shqipëri 2019 (HMS 2019) ishte një anketë pranë familjeve, e dedikuar për mbledhjen e të dhënave për migracionin.

Rezultatet e studimit janë përqendruar në karakteristikat kryesore demografike të Njësive Ekonomike Familjare (NJEF) dhe popullsisë, që kanë ndryshuar vendbanimin e tyre në krahasim me vendbanimin që kishin në vitin 2011 (Censi i fundit i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri, 2011).

Pas mbledhjes së të dhënave u arrit të mblidhet informacion i suksesshëm për rreth 20 mijë NJEF dhe rreth 72 mijë individë. Anketa e migracioni siguron një informacion, si në rang NJEF ashtu edhe individë. Nëpërmjet saj është vlerësuar për herë të parë numri i NJEF-ve që janë larguar nga vendi. Nga të gjithë NJEF-të e identifikuar në CENSUS 2011, rreth 584 mijë NJEF ose 77,9 % nuk kanë asnjë anëtar që është larguar (emigruar) gjatë periudhës 2011-2019. 166 mijë NJEF ose 22,1 % kishin në 2019 të paktën një anëtar të larguar jashtë vendit. Nga të gjithë banorët rezident në CENSUS 2011, rreth 2,2 milion individë nuk kanë ndryshuar vendbanimin e tyre të zakonshëm në 2019, që prej 2011 (nuk kanë emigruar/imigruar jashtë vendit ose nuk kanë lëvizur brenda vendit).

Numri i individëve gjithsej të larguar nga Shqipëria, në 2019 rezulton 360.699 banorë, ose rreth 12,4 % e popullsisë gjithsej të vitit 2011

Fig. 11: Anëtarët emigrues të familjeve me migracion të pjesshëm deri më 15 korrik 2019, sipas moshës dhe gjinisë



Shënim: Emigrantët neto që nga viti 2011. Anëtarët e NJEF-ve që janë larguar me të gjithë familjen nuk janë marrë në konsideratë.


Burimi: [Anketa e Migracionit, 2019](#)

Flukset më të mëdha që u vrojtuan ishin drejt Greqisë dhe Italisë. Për të gjitha destinacionet, fluksi i emigracionit ishte i shpërndarë në mënyrë të barabartë përgjatë gjithë periudhës 2011-2019. Ky fluks dalës u diversifikua në raport me nivelin dhe strukturën:

- 120.754 persona u larguan për në Itali dhe nuk ishin kthyer deri në vitin 2019;
- Greqia priti 92.159 emigrantë;
- 40.468 u larguan për në Gjermani.

Në figurën e mëposhtme janë arsyet përse anëtarët e familjeve me profil migracioni të pjesshëm u larguan nga vendi. Është sërish me rëndësi të theksohet se gjetjet përfshinin familjet e pranishme gjatë kohës së censit 2011, d.m.th. familjet me kryefamiljar me qëndrim në Shqipëri në 2011. Përfundimi kryesor është se arsyet kryesore të largimit nga vendi ishin problemet financiare dhe kushtet e jetesës ndërsa për kthimin, arsyet familjare. Për fat të keq, AMF-ja nuk ofroi informacion lidhur me motivet e familjeve që kanë lëvizur tërësisht apo planet e tyre për të ardhmen.

Fig. 12: Struktura e familjeve shqiptare me migracion të pjesshëm sipas arsyes së emigracionit



Shënim: Emigrantët neto që nga viti 2011. Anëtarët e NjEF-ve që janë larguar me të gjithë familjen nuk janë marrë në konsideratë.

Burimi: [Anketa e Migracionit, 2019](#)

REFERENCA

- Eurostat Database (2019), Immigration by age group, sex and citizenship (migr_imm1ctz):
https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr_imm1ctz&lang=en
- Eurostat Database (2019), Immigration by age group, sex and country of birth (migr_imm3ctb) :
https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr_imm3ctb&lang=en
- United States Census bureau, ACS 1-Year Estimates-Public Use Microdata Sample (2019):
<https://data.census.gov/cedsci/>
- European Statistical System, Census Hub (2011) :
<https://ec.europa.eu/CensusHub2/query.do?step=selectHyperCube&qhc=false>
- UNDESA (2019) International migrant stock :
<https://www.un.org/en/development/desa/population/migration/data/estimates2/estimates19.asp>
- Ministri i Shtetit për Diasporën, Diaspora Shqiptare <http://online.fliphtml5.com/dmiin/kgyt/#p=1>
- France The National Institute of Statistics and Economic (2017), Foreigners - Immigrants: country of birth and detailed nationalities:
<https://www.insee.fr/fr/statistiques/4510549?sommaire=4510556#consulter-sommaire>
- Ljubica Nedelkoska and Nick Khaw (2015) “The Albanian Community in the United States, Statistical Profiling of the Albanian-Americans”
- Nagi, Dennis L. The Albania-American Odyssey. A Pilot Study of the Albanian Community of Boston, Massachusetts, New York: AMS Press, 1988.
- Dinamikat e Popullsisë (2014) “Horizonte të reja” INSTAT:
http://www.instat.gov.al/media/3074/popullsia_dhe_dinamikat_e_saj_-_horizonte_t_reja_demografike.pdf
- Anketa Kombëtare e Migracionit në Familje në Shqipëri (2019), Giz, INSTAT, IOM
https://albania.iom.int/sites/default/files/publication/Zhvillimi_i_anket%C3%ABs_komb%C3%ABtare_t%C3%AB_migracionit_n%C3%AB_familje_ALB.pdf